

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ARTUR MALAJ

08/03/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 31.07.2018 për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 03.08.2018, vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Artur Malaj, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese e kryesuar nga znj. Genta Tafa (Bungo), znj. Pamela Qirko relatores, znj. Suela Zhegu anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.